



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raport për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale

(Janar - Dhjetor, 2022)

Prishtinë, 2023

Hyrje

Strategjia për Vetëqeverisje Lokale është dokumenti kryesor i prodhuar nga Ministria e Pushtetit Lokal – MAPL i cili fokusohet në vetëqeverisjen lokale në Kosovë. Ky dokument është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin 04/63 të datës 10.12.2016 së bashku me Planin e Veprimit të Strategjisë dhe përfshinë periudhën 2016 – 2026. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale është dokument i cili përcakton një kornizë të politikave prioritare të Qeverisë, me qëllim të avancimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë për një periudhë afatgjatë dhjetëvjeçare (2016-2026) dhe është dokument ndër - sektorial.

Në përputhje me Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe me qëllim të përcjelljes së rregullt të zbatimit të kësaj strategjie, Ministria e Pushtetit Lokal si institucion përgjegjës (koordinues) për implementimin e kësaj strategjie ka nxjerr aktivitetet konkrete nga Plani i veprimit të Strategjisë për këtë periudhë. Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i procesit të zbatimit të aktiviteteve të cilat dalin nga kjo strategji dhe përcaktimi i hapave për realizimin e detyrimeve të zotuarra nga institucionet e Republikës së Kosovës për avancimin e vetëqeverisjes lokale në vend.

MAPL konform përgjegjësi që ka monitoruar zbatimin e kësaj strategji në baza gjashtëmujore. Ky raport pasqyron zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 për periudhën Janar – Dhjetor, 2022. Raporti u shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi në zbatimin e kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare, publikut të gjerë dhe jo vetëm. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 ka gjithsej 5 objektiva:

- I. **Objektiva strategjike 1** – Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e Komunave;
- II. **Objektiva Strategjike 2** – Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave;
- III. **Objektiva Strategjike 3** – Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;
- IV. **Objektiva Strategjike 4** – Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive;
- V. **Objektiva Strategjike 5** - Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Objektiva strategjike - I

Në kuadër të programit CIF 2 janë 7 komuna përfitues për 7 projekte në vlerë prej 1,080,768.38 €. Për projektet infrastrukturore për komunitete janë përzgjedhur 28 projekte në 20 komuna, në vlerë prej 1,000,000.00 €. Për projektet e CIF janë nënshkruar marrëveshjet për 12 projekte. Nga granti i performancës komunale, janë 14 komunat përfituese me 60 projekte. Në kuadër të projektit M4Y është bërë thirrja për propozime për subgrante për adoleshent (15-18), dhe për të rritur (18-24) për ciklin e parë të granteve, si dhe është paraqitur lista e fituesve të subgranteve për ciklin e parë të granteve. Është dizajnuar dhe lansuar web-faqja e internetit M4Y. Në këtë vit ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë - Shqipëri, Kosovë - Maqedoni dhe Kosovë - Mali i Zi. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 iniciativa/nisma, për bashkëpunim ndërkomunal, dhe 7 iniciativa/nisma për bashkëpunim komunal ndërkombëtar, ndërsa janë nënshkruar 2 marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal dhe 2 marrëveshje për bashkëpunim komunale ndërkombëtare. Gjithashtu, është vlerësuar një iniciativë për binjakëzim të Komunës së Pejës me Komunën e Kırklareli- Republika e Turqisë. MAPL në këto vite, ka hartuar Koncept-dokumentin për bashkëpunim ndërkomunal.

Objektiva Strategjike - 2

Gjithashtu fokus të veçantë i është dhënë edhe finalizimit të akteve nënligjore dhe dokumenteve të parapara në programin legjislativ për vitin 2022, si në vijim: (1 Vlerësim Ex post; 2 Koncept dokumente; 3 akte nënligjore. MAPL ka përmbyllur Studimin e Fizibilitetit për Qeverisje Lokale, gjithashtu në këtë periudhë është hartuar edhe raporti dhe programi i orientimeve afatmesme dhe afatgjate të sistemit të qeverisjes lokale, të cilat janë përcjellë për miratim në qeveri. Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, në total janë pranuar 50 akte. Janë monitoruar dhe kanë funksionuar 38 komuna të Republikës së Kosovë, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2280 akte, prej tyre 107 rregullore dhe 2173 vendime. Nga gjithsej 2280 akte, MAPL ka vlerësuar 1160 akte, përderisa 1120 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e linjës. MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2022. Sa i përket identifikimit të shërbimeve të one stop shop, sipas të dhënave nga raporti i përmbylljes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane, në periudhën Janar - Dhjetor, 2022 janë 31 komuna të cilat kanë funksionalizuar këto qendra ndërsa mbetet në 7 komuna (Malishevë, Mamushë, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan, Prishtinë, Junik) funksionalizimi i tyre.

Objektiva Strategjike - 3

Në bashkëpunim me IKAP dhe donator të ndryshëm, janë realizuar trajnime me temën: "Ndryshimet në legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë; Matja e Performancës Komunale; Procesi përgatitor i raportimit të performancës për vitin 2021; Transparenca komunale, përgjegjshmëria, arsimi parauniversitar, shëndetësia primare dhe barazia gjinore; Hartimi dhe monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna; Praktikat e mira në fushën e

bashkëpunimit ndërkomunal; Barazia gjinore në nivel lokal; Menaxhimi i kontratave, përdorimin e platformës elektronike në prokurim; Menaxhimi i pronës komunale; Komunikimin me media dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe përdorimin e rrjeteve sociale. Është përgatitur Raporti i Vlerësimit të nevojave për trajnime bazuar në përgjigjet e mara nga pyetësi i dërguar në të gjitha komunat.

Objektiva Strategjike - 4

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka mbajtur 5 takime me Forumin Konsultativ për Qeverisje Lokale me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të diskutimit të fushave që prekin vetëqeverisjen lokale në Kosovë. MAPL ka përfshirë shoqërinë civile në kuadër të grupeve punuese për hartimin e akteve ligjore dhe nën ligjore. MAPL ka finalizuar planin e monitorimit për transparencë në komuna dhe janë identifikuar të gjithë treguesit e transparencës që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar monitorimi i web-faqeve të komunave, për të parë nivelin e përmbushjes së obligimeve për informimin e publikut sipas kriterëve të kërkuara ligjore. Lidhur me zbatimin e projektit (platformës online), MAPL në kuadër të ndryshimeve dhe politikave zhvillimore, ka për qëllim të përmirësoj kontrollin e brendshme dhe rritjen e transparencës. Me qëllim të intensifikimit dhe bashkëpunimit me institucionet ndërmministrorë dhe sektorin e shoqërisë civile, MAPL ka marrë pjesë në takime të ndryshme me qëllim të promovimit të ndërmarrësisë sociale në Kosovë, me fokus të veçantë në nivelin lokal. Në kuadër të qeverisjes së hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, i cili është hartuar dhe është miratuar nga Qeveria. MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT, në kuadër të portalit shtetëror E-KOSOVA. Platforma E-Komunat është lansuar me 02 shtator 2022.

Objektiva Strategjike - 5

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, së fundi ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për mbështetje financiare për studentët të komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë. Raporti nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2021, thekson se lidhur me fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore pasi që sipas të dhënave vetëm 7 komuna (Vushtrri, Rahovec, Pejë, Junik, Skenderaj, Deçan, dhe Prizren) kanë hartuar planin për trashëgimi kulturore. Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoçën e Madhe, komuna e Rahovecit ka siguruar një zyrë në komunë për mbajtjen e mbledhjeve dhe aktivitetet tjera gjithashtu për këtë periudhë është alokuar buxhet në vlerë prej 25.028.00 euro. Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka funksionuar Këshilli dhe nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Gjithashtu komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumëbardhi ka ndërmarrë aktivitete si: mbrojtja e shtratit të lumit, rehabilitimi i urave të qytetit, mbrojtja nga

ujërat e zeza, pastrimi i lumit etj. Sa i përket aktiviteteve që kanë ndërmarr komunat për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në 27 komuna janë ndërmarr aktivitetet si në vijim: fushata vetëdijësuese, shpërndarje të broshurave të ndryshme për të trashëgimisë kulturore, organizime të vizitave në muze për nxënës të shkollave të mesme dhe student, emisione promovuese në mediat lokale, organizimi i tryezave promovuese të trashëgimisë kulturore, subencionim i projekteve për promovimin e trashëgimisë kulturore nga OJQ-të dhe individët, organizimi i ekspozitave kolektive të pikturës, bashkëpunimi me donatorë mbështetës për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, shenjzimi i aseteve të Trashëgimisë Kulturore, janë punuar guida, harta të monumenteve, renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, harta dixhitale, janë ridizajnuar të gjitha panelet informative turistike, janë botuar libra nga ekspertët e kësaj lëmie.

ZBATIMI I AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË PËR VETËQEVERISJE LOKALE, JANAR - DHJETOR 2022

Objektiva strategjike 1 – Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e Komunave.

RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË SVL-SË PËR OBJEKTIVIN 1

- MAPL në baza vjetore monitoron dhe raporton për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik lokal 2019 – 2023. Për këtë qëllim është dërguar shkresa tek komunat dhe ministritë e linjës ku janë bartëse të aktiviteteve në kuadër të planit të veprimit të strategjisë për të raportuar lidhur me realizimin e aktiviteteve të dala nga plani i veprimit të SZHEL.
- Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Është bërë lansimi i fondit nga programi CIF 2 dhe CIF, janë realizuar 5 sesione informuese në 5 rajone. Në kuadër të programit CIF 2 janë 7 komuna përfitues për 7 projekte në vlerë prej 1,080,768.38 €. Për projektet infrastrukturore për komunitete janë përzgjedhur 28 projekte në 20 komuna, në vlerë prej 1,000,000.00 €. Për projektet e CIF janë nënshkruar marrëveshjet për 12 projekte. Nga granti i performancës komunale, në vlerë të përgjithshme prej 8,000,000.00 € prej tyre 3,000,000.00 € nga buxheti i MAPL dhe 5,000,000.00 € nga buxheti i donatoreve janë 14 komunat përfituese me 60 projekte, ku nga buxheti i MAPL janë 8 komuna përfituese me 25 projekte dhe nga buxheti i DEMOS janë 6 komuna përfituese me 35 projekte.

- MAPL në bashkëpunim me SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti për performancë komunale për komunat të cilat gjatë vitit 2019 kanë treguar performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve. Për 21 komunat përfituese, nga programi për bashkëfinancim me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave në bashkëpunim me projektin DEMOS dhe donatoret e tjerë janë financuar 57 projekte në vlerë prej 3,615,474.00€. Ndërsa, ka filluar vlerësimi i komunave për performancën e vitit 2021 ka janë pranuar të dhënat nga komunat, është bërë përpunimi i të dhënave. Sa i përket vlerësimit të performancës së komunave për grantin e performancës për vitin e alokimit 2023, sipas rezultateve të performancës së vitit 2021, është hartuar analiza për kushtet minimale të GPK-së. Qeveria ka provuar nisma për negocimin e marrëveshjes ndërkombëtare për GPK, është themeluar grupi negociatorë, është hartuar draft-marrëveshja, dhe pas finalizimit do të dërgohet për miratim në kuvend.
- Në kuadër të projektit M4Y është bërë shtrirja dixhitale dhe mediatike duke krijuar 13 postera dixhitalë me të rinjtë dhe me fokus tek gratë, me qëllim që të inkurajohen dhe të aplikojnë për trajnime dhe grante dhe janë përzgjedhur 50 komunitete të synuara të cilat kanë filluar aktivitetet e mobilizimit dhe shtrirjes në të gjitha komunat. Është bërë formimi i grupeve të të rinjëve për ciklin parë të granteve, dhe është bërë identifikimi i drejtuesve të të rinjëve. Është bërë shqyrtimi i nënprojekteve për provueshmëri për ciklin e parë të granteve. Është bërë themelimi i komiteteve të vlerësimit të nëngranteve, është bërë thirrja për propozime për subgrante për adoleshent (15-18), dhe për të rritur (18-24) për ciklin e parë të granteve, si dhe është paraqitur lista e fituesve të subgranteve për ciklin e parë të granteve. Është dizajnuar web-faqja e internetit M4Y, e cila do të lansohet në tetor të këtij viti. Thirrja e Parë për Propozime është hapur në dhjetë komuna partnere në muajin maj 2022. Janë pranuar 185 aplikime.
- Në këtë vit ka vazhduar avancimi i bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të tri programeve: Kosovë - Shqipëri, Kosovë - Maqedoni dhe Kosovë - Mali i Zi. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 iniciativa/nisma, për bashkëpunim ndërkomunal, dhe 7 iniciativa/nisma për bashkëpunim komunal ndërkombëtar, ndërsa janë nënshkruar 2 marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal dhe 2 marrëveshje për bashkëpunim komunale ndërkombëtare. Gjithashtu, është vlerësuar një iniciativë për binjakëzim të Komunës së Pejës me Komunën e Kirklareli- Republika e Turqisë. MAPL në këtë vite, ka hartuar Koncept-dokumentin për bashkëpunim ndërkomunal.

Objektiva Strategjike 2 – Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave.

RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË SVL-SË PËR OBJEKTIVIN 2

MAPL në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, ka ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna komform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Në bashkëpunim me KLG është realizuar trajnimi 2 ditor me temën "Ndryshimet në

legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë" dhe "Matja e Performancës Komunale". Ndërsa në bashkëpunim me IKAP dhe DEMOS është realizuar trajnimi 4 ditorë me sesione trajnuese për procesin përgatitor të raportimit të performancës për vitin 2021. Trajnimi është mbajtur në fushat: Transparenca, komunale, përgjegjshmëria, arsimi parauniversitar, shëndetësia primare dhe barazia gjinore. Në të gjitha këto trajnime, pjesëmarrës kanë qenë 151 zyrtarë komunal. Janë organizuar 6 trajnime konform programit dhe kornizës kohore të planifikuara. Në bashkëpunim me IKAP dhe me mbështetjen e OSBE-së, janë organizuar trajnime 1 ditore në 5 regionet e Kosovës, lidhur me Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. Në bashkëpunim me OSBE dhe IKAP në fushën e bashkëpunimit nder komunal janë realizuar 5 sesione trajnimesh - pjesëmarrës kanë qenë 50 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me UNDP është realizuar trajnimi dy ditor në fushën e të drejtave të njeriut me temën "Barazia gjinore" Pjesëmarrës kanë qenë 26 zyrtar komunal. Në 5 sesione trajnimesh për periudhën janar - tetor janë trajnuar gjithsej 289 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, është mbajtur trajnimi një ditor për zyrtarët e MAPL-së, "Menaxherët e kontratave, përdorimin e platformës elektronike modulit e Menaxhimit të Kontratës", pjesëmarrës kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së. Në bashkëpunim me IKAP është realizuar trajnimi me temën "Menaxhimi i pronës komunale" pjesëmarrëse kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së. Në bashkëpunim me OSBE është realizuar trajnimi me temën "Komunikimin me media dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe përdorimin e rrjeteve sociale" pjesëmarrës kanë qenë gjithsej 69 zyrtar komunal. Është përgatitur Raporti i Vlerësimit të nevojave për trajnime bazuar në përgjigjet e mara nga pyetësi i dërguar në të gjitha komunat.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022, MAPL ka shënuar progres në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisjes lokale, duke përmbyllur aktivitetet kryesore në këtë fushë. Gjithashtu fokus të veçantë i është dhënë edhe finalizimit të akteve nënligjore dhe dokumenteve të parapara në programin legjislativ për vitin 2022, si në vijim:

- Vlerësimi Ex post i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (është përgatitur raporti përfundimtar lidhur me vlerësimin ex post dhe është miratuar nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit);
- Koncept dokument për Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (është finalizuar është dërguar në Qeveri për miratim);
- Koncept-dokumenti për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim (është formuar Grupi punues, dhe është hartuar drafti koncepti, tani gjendet në procedurë të konsultimit publik dhe paraprak, do të dërgohet për miratim në Qeveri në tre muajt e parë të vitit 2023);
- Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr.04/2019 për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (është në proces të finalizimit)
- Projekt Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e proceduarve për zbatimin e gjuhëve në komuna (është miratuar dhe ka hyre në fuqi);
- Projekt Udhëzimi Administrativ (QRK) për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës (është miratuar në Qeveri dhe ka hyrë në fuqi).
- MAPL ka përmbyllur Studimin e Fizibilitetit për Qeverisje Lokale, gjithashtu në këtë periudhë është hartuar edhe raporti dhe programi i orientimeve afatmesme dhe afatgjate të sistemit të qeverisjes lokale, të cilat janë përcjellë për miratim në qeveri. Qeveria i ka shqyrtuar dokumentet e lartpërmendura dhe janë publikuar. Është hartuar doracaku për

konsultimet publike në komuna, model plani për integritet për komuna dhe doracaku për zbatimin e planit për integritet në komuna.

- Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, në total janë pranuar 50 akte ligjore dhe nënligjore prej tyre: 15 Projekt Ligje, 2 Projekt Rregullore, 28 Projekt Udhëzime Administrative dhe 5 Koncept Dokumente. Ndërsa, lidhur me shkresat njoftuese që adresohen në komuna, në këtë periudhë kohore janë pranuar dhe shqyrtuar 250 kërkesa dhe 35 ankesa nga personat fizik dhe juridik.
- Në periudhën Janar –dhjetor 2022, kanë funksionuar 38 komuna të Republikës së Kosovë, duke mbajtur mbledhje rregullisht. Kuvendet e komunave kanë mbajtur 513 mbledhje. Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë monitoruar përmes sistemit të teleprezencës, si dhe prezencës fizike të zyrtarëve për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 2280 akte, prej tyre 107 rregullore dhe 2173 vendime. Nga gjithsej 2280 akte, MAPL ka vlerësuar 1160 akte, përderisa 1120 akte të tjera janë dërguar në Ministrinë e linjës.
- MAPL rëndësi të madhe i ka kushtuar edhe çështjes së të drejtave të njeriut, në veçanti segmentit të të drejtave të fëmijëve. Në këtë drejtim, MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për vitin 2022.
- Sa i përket identifikimit të shërbimeve të one stop shop, sipas të dhënave nga raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane, në periudhën Janar – Dhjetor, 2022 janë 31 komuna të cilat kanë funksionalizuar këto qendra ndërsa mbetet në 7 komuna (Malishevë, Mamushë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan, Prishtinë, Junik) funksionalizimi i tyre.

Objektiva Strategjike 3 – Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët.

RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË SVL-SË PËR OBJEKTIVIN 3

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve MAPL ka mbajtur trajnim dy ditorë me zyrtarë për barazi gjinore në komuna, të mbështetur nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna komform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Në bashkëpunim me KLG është realizuar trajnimi 2 ditor me temën "Ndryshimet në legjislacionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë" dhe "Matja e Performancës Komunale". Ndërsa në bashkëpunim me IKAP dhe DEMOS është realizuar trajnimi 4 ditorë me sesione trajnuese për procesin përgatitor të raportimit të performancës për vitin 2021. Trajnimi është mbajtur në fushat: Transparenca, komunale, përgjegjshmëria, arsimi parauniversitar, shëndetësia primare dhe barazia gjinore. Në të gjitha këto trajnime, pjesëmarrës kanë qenë 151 zyrtarë komunal. Janë organizuar 6 trajnime konform programit dhe kornizës kohore të planifikuar. Në bashkëpunim me IKAP dhe me mbështetjen e OSBE-së, janë organizuar trajnime 1 ditore në 5 regjionet e Kosovës, lidhur me Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit për integritet në komuna. Në bashkëpunim me OSBE dhe IKAP në fushën e bashkëpunimit nder komunal janë realizuar 5 sesione trajnimesh - pjesëmarrës kanë

qenë 50 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me UNDP është realizuar trajnimi dy ditor në fushën e të drejtave të njeriut me temën "Barazia gjinore" Pjesëmarrës kanë qenë 26 zyrtar komunal. Në 5 sesione trajnimesh për periudhën janar - tetor janë trajnuar gjithsej 289 zyrtar komunal. Në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, është mbajtur trajnimi një ditor për zyrtarët e MAPL-së, "Menaxherët e kontratave, përdorimin e platformës elektronike modulin e Menaxhimit të Kontratës", pjesëmarrës kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së. Në bashkëpunim me IKAP është realizuar trajnimi me temën "Menaxhimi i pronës komunale" pjesëmarrëse kanë qenë 20 zyrtar të MAPL-së.

Ne bashkëpunim me OSBE është realizuar trajnimi me temën "Komunikimin me media dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe përdorimin e rrjeteve sociale" pjesëmarrës kanë qenë gjithsej 69 zyrtar komunal.

Është përgatitur Raporti i Vlerësimit të nevojave për trajnime bazuar në përgjigjet e mara nga pyetëtori i dërguar në të gjitha komunat.

Në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, është mbajtur trajnimi një ditor për zyrtarët e MAPL-së, "Menaxherët e kontratave, përdorimin e platformës elektronike modulin e Menaxhimit të Kontratës".

Objektiva Strategjike 4 – Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË SVL-SË PËR OBJEKTIVIN 4

Temat për mjedisin janë inkorporuar si pjesë e plan-programeve mësimore dhe mësimdhënësit i ligjërojnë këto tema në kuadër të lëndëve "Edukatë qytetare", "Njeriu dhe natyra" etj. Gjithashtu, në kuadër të organizimeve për nder të festave mjedisore, si "Dita e Tokës, "Dita e mjedisit" etj., shkollat kanë realizuar aktivitete të shumta për pastrimin e objekteve shkollore dhe ambientit.

- Ministria e Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale, në monitorimin e proceseve rekrutuese, si dhe implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka mbajtur 5 takime me Forumin Konsultativ për Qeverisje Lokale me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të diskutimit të fushave që prekin vetëqeverisjen lokale në Kosovë. Si rezultat i takimeve me organizatat e shoqërisë civile ka dal edhe dokument i pozicioneve të shoqërisë civile për organet e reja komunale që do të dalin pas zgjedhjeve lokale të vitit 2022, që do t'ju shërbej akterëve lokal. Ndërsa, me qëllim të promovimit të aktiviteteve me organizatat e shoqërisë civile, në kuadër të linkut të Forumit Konsultativ për Qeverisje Lokale në ueb faqen zyrtare të MAPL-së, janë përditësuar të dhënat dhe janë shtuar të dhëna të reja lidhur me aktivitetet e përbashkëta.
- MAPL ka përfshirë shoqërinë civile në kuadër të grupeve punuese për zhvillimin e akteve nën ligjore, pastaj në kuadër të grupeve punuese për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026, në kuadër të studimit të fizibilitetit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, si dhe në kuadër të grupeve tjera për avancimin e mëtutjeshëm të sistemit të VQL-së.

- MAPL ka finalizuar planin e monitorimit për transparencë në komuna dhe janë identifikuar të gjithë treguesit e transparencës që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. Plani identifikon njësitë kryesore të MAPL-së përgjegjëse për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të transparencës.
- Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar monitorimi i web-faqeve të komunave përmes për të parë nivelin e përmbushjes së obligimeve për informimin e publikut sipas kriterëve të kërkuara ligjore. Është hartuar raporti Janar -dhjetor 2022 i monitorimit të web-faqeve të komunave dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen zyrtare të MAPL-së.
- Lidhur me zbatimin e projektit (platformës online), MAPL në kuadër të ndryshimeve dhe politikave zhvillimore, ka për qëllim të përmirësoj kontrollin e brendshme dhe rritjen e transparencës. Lidhur me zbatimin e projektit (platformës online) për rritjen e llogaridhënies institucionale dhe transparencës buxhetore, ky projekt është bashkëfinancim i Ambasadës Britanike dhe MAPL-së, ku vlera totale e projektit arrin shumën 60 mijë euro, (40 mijë euro nga Ambasada Britanike dhe 20 mijë euro nga MAPL), ndërkaq zbatues i projektit është UNDP. Është funksionalizuar platformës për “Rritjen e kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore të shpenzimeve të fondeve publike të MAPL-së” dhe janë mbajtur trajnimet për zyrtarët e MAPL-së për: modulën e KASH, modulën e buxhetit, modulën kërkesat e mia - udhëtimet zyrtare, moduli i transparencës dhe llogaridhënies, moduli i veturave, moduli i *petty cash*, moduli i projekteve kapitale, moduli i prokurimit dhe moduli i shpenzimeve. Ka vazhduar raportimi online në sistemin e integruar të monitorimit dhe raportimit, megjithëse ka pasur ankesa në vazhdimësi nga stafi për mosfunksionimin e kësaj platforme. Në të njëjtën kohë ka vazhduar procedimi i akteve të cilat i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ligjshmërisë.
- Me qëllim të intensifikimit dhe bashkëpunimit me institucionet ndërmministrorë dhe sektorin e shoqërisë civile, MAPL ka marrë pjesë në takime të ndryshme me qëllim të promovimit të ndërmarrësisë sociale në Kosovë, me fokus të veçantë në nivelin lokal.
- Në kuadër të qeverisjes së hapur si njëri nga parimet themelore të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nismën e MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të fillohet me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025 për qeverisje të hapur në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur – PQH. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka krijuar dhe funksionalizuar Komitetin Nacional Koordinues, i cili është komitetet gjithëpërfshirës i përbërë nga institucionet relevante publike, organizatat e shoqërisë civile si bashkëudhëheqëse, sektorin e biznesit, organizatat dhe institucionet tjera relevante vendore e ndërkombëtare. Pas procesit të konstituimit të Komitetit Nacional Koordinues për OGP, komiteti i udhëhequr nga MAPL ka zhvilluar 10 takime të komitetit, ka zhvilluar serinë e konsultimeve publike në 7 regjione të Kosovës për hartimin e Planit Nacional të Veprimit (PNV) 2023-2025, si dhe janë zhvilluar 4 punëtori tematike të Komitetit Nacional Koordinues. Në kuadër të këtyre konsultave janë përfshirë më shumë se 250 deri 300 entitete (organizata, institucione, përfaqësues të bizneseve etj). Gjithashtu janë përgatitë për aplikim dy dokumentet bazike ai i vlerësimit të kriterëve minimale dhe letra e interesit. Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është hartuar ka kaluar në dy proceset e konsultimit paraprak dhe konsultimit publik deri me datën 30 shtator 2022 dhe është miratuar nga Qeveria.
- MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale duke rritur efikasitetin e këtyre

shërbimeve karshi qytetarëve. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka krijuar dhe funksionalizuar Këshillin Koordinues, i cili është këshill gjithëpërfshirës i përbërë nga institucionet relevante publike, organizatat e shoqërisë civile, sektorin e biznesit, organizatat dhe institucionet tjera relevante vendore e ndërkombëtare. Në bashkëpunim me DEMOS ka filluar procesi i studimit të fizibilitetit për platformën E-KOMUNAT, si dhe është arritur që të nënshkruhet marrëveshje e bashkëpunimit me Akademinë për E-Qeverisje të Estonisë për zhvillimin e platformës E-KOMUNA. Platforma E-KOMUANT është përfshirë në dokumentin qeveritar në Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative dhe është në proces të integritimit në Strategjinë Kombëtare për Digjitalizim. Me 02 shtator 2022 është bërë lansimi i platformës E-KOMUNAT në kuadër të portalit shtetëror E-KOSOVA. Me datën 30 shtator 2022 është publikuar dosja e tenderit në platformën E-Prokurimi për zhvillimin e fazës së dytë të platformës E-KOMUNAT. Platforma E-Komunat është lansuar me 02 shtator 2022.

Objektiva Strategjike 5 - Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor.

RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË SVL-SË PËR OBJEKTIVIN 5


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, së fundi ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për mbështetje financiare për studentë të komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom të cilët studiojnë në universitetet publike në Kosovë. Raporti nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2021 thekson se lidhur me fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore pasi që sipas të dhënave vetëm 7 komuna (Vushtrri, Rahovec, Pejë, Junik, Skenderaj, Deçan, dhe Prizren) kanë hartuar planin për trashëgimi kulturore. Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoçën e Madhe, komuna e Rahovecit ka siguruar një zyrë në komunë për mbajtjen e mbledhjeve dhe aktivitetet tjera gjithashtu për këtë periudhë është alokuar buxhet në vlerë prej 25.000.00 euro. Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar-Dhjetor 2022 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet. Nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Gjithashtu komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumëbardhi ka ndërmarrë aktivitete si: mbrojtja e shtratit të lumit, rehabilitimi i urave të qytetit, mbrojtja nga ujërat e zeza, pastrimi i lumit etj. Sa i përket aktiviteteve që kanë ndërmarr komunitet për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në 27 komuna janë ndërmarr aktivitete si në vijim: fushata vetëdijësuese, shpërndarje të broshurave të ndryshme për të trashëgimisë kulturore, organizime të vizitave në muze për nxënës të shkollave të mesme dhe student, emisione promovuese në mediat lokale, organizimi i tryezave promovuese të trashëgimisë kulturore, subevencionim i projekteve për promovimin e trashëgimisë kulturore nga OJQ-të dhe individët, organizimi i ekspozitave kolektive të pikturës, bashkëpunimi me donatorë mbështetës për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, shenjëzimi i aseteve të Trashëgimisë Kulturore, janë punuar guida, harta të monumenteve, renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, harta dixhitale, janë ridizajnuar të gjitha panelet informative turistike, janë botuar libra nga ekspertët e kësaj lëmie.

PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në këtë raport, MAPL ka shënuar progres në zbatimin e objektivave strategjike (edhe pse disa veprime në kuadër të këtyre objektivave nuk janë në domenin e MAPL-së, megjithatë ka arritur t'i zbatoj të gjitha objektivat).

Objektivi	Veprimet e planifikuara	Veprimet e përfunduar	Veprimet e papërfunduara	Veprimet e bartur në vitin 2021	Përqindja
Objektivi 1	2	1	1	0	50%
Objektivi 2	6	6	0	0	100%
Objektivi 3	5	5	0	0	100%
Objektivi 4	3	1	2	0	34%
Objektivi 5	3	3	0	0	100%
Totali	19	16	3	0	84%

Tabela 1: aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2021.



Diagrami 2: Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve në kuadër të Strategjisë për Vetëqeverisje lokale.

RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Ndërsa, si sfida mbasin: a) Funkcionalizimi i 5 nëngrupeve punuese për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, b) Emërimi i një koordinatori për koordinimin e nëngrupeve punuese, c) Ndryshimi i planit të veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, si dhe d) Raportimi nga institucionet përkatëse.

Më qëllim që të adresohen këto sfida, duhet të ndërmerren hapat vijues, si: a) Funkcionalizimi i Grupit dhe Funkcionalizimi i 5 nëngrupeve punuese për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, b) Emërimi i një koordinatori për koordinimin e punës së grupit dhe nëngrupeve punuese, c) Rishikimi i planit të veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, si dhe d) Raportimi nga institucionet përkatëse.

Shtojca 1: Plani i Monitorimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale

Objektivi Strategjik 1: Krijimi i kornizës ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e Komunave

Nr	Fusha e veprimit	Veprimi	Bartësi	Treguesi / rezultati
1.1	1.Aftësimi i të rinjve, si fuqi punëtore	1. Hartimi i skemave programore ne sektorin bujqësor	MAPL, MASHT, MF MBZHR Komunat	1. Është hartuar një skemë programore për punësim në sektorin bujqësor;

Objektivi Strategjik 2:Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave

Nr	Fusha e veprimit	Veprimi	Bartësi	Treguesi / rezultati
2.1	1.Rishikimi dhe krijimi i bazës ligjore	1. Harmonizimi i legjislacionit sekondar me legjislacionin e brendshëm dhe asquis communautaire	MAPL. Komunat AKK Ministrit e Linjes MF ZKM	1. Janë hartuar ligjet e reja që plotësojnë kornizën ligjore të VQL, sipas prioriteteve;
		1. Krijimi i mekanizmave të plotë ligjor dhe administrativ për mbikëqyrje efektive në mbrojtjen e ligjshmërisë gjatë punës së komunave;		1.Është bërë harmonizimi i legjislacionit të brendshëm për VQL dhe janë në zbatim;
				Në secilin vit bëhet mbikëqyrja e zbatimit të kornizës ligjore, programeve dhe I projekteve nga MAPL në komuna
2.2	1.Rritja e efikasitetit në administratën lokale	1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale në komuna;	MAPL . MAP- IKAP; AKK; Donatore	1. Është ngritur një zyrë për këshilla juridike për qytetarët,
		1. Avancimi i rolit përfaqësues të organeve Komunale;		2. Janë organizuar së paku 20 ditë trajnime në vit për secilën fushë organizative në komuna;
		2. Ndërtimi i kapaciteteve fizike dhe teknike në komuna		3. Janë organizuar dy ditë trajnime në vit për rolin e komunitetit në qeverisjen e mirë:
		4.identifikimi isherbimeve qe mund te ofrohen on-line		4.Janë zhvilluar standardet për shërbimet themelore komunale;

2.3	1.Pjesëmarrja efektive e qytetarëve në qeverisje	1. Hartimi i politikave për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;	MAPL ; Komunitat, AKK; Donatorët	1. Në secilën komunë qytetarët marrin pjesë në punë të përbashkëta me strukturat komunale;
-----	--	---	----------------------------------	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët

Nr	Fusha e Veprimit	Veprimi	Bartësi	Treguesi / rezultati
3.1	1.Zhvillimi i kapaciteteve profesionale	1.Ndërtimi I kapaciteteve profesionale te orgneve lokale	MAPL; MAP- IKAP; MF; Komuna	1. Janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal sipas standardeve të kompetencës profesionale;
3.2	1.Ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese të administratës	1. Hartimi i programeve të integruara të trajnimit në fushën e administratës publike dhe qeverisjes së mirë për zhvillim të kapaciteteve profesionale të stafit të komunave. 2.Eshte bere vleresimi profesional I arritjeve ne pune	MAPL; MAP- IKAP MF; Komunitat	1. Për të gjitha fushat e punës në komunë raportohet në baza javore mujore dhe vjetore; 1. Është bërë vlerësimi i kompetencës profesionale për zyrtarët komunal dhe janë lëshuar certifikata, sipas nivelit të trajnimit dhe arritjeve profesionale.
	1.Përfshirja e shoqërisë civile dhe sektorit privat në ofrimin e shërbimve	1. Hartimi i projekteve të përbashkëta publiko - private	MAPL; Komunitat; AKK; OJQ-të; Komuniteti	1. Komuniteti merr pjesë aktive në punë të përbashkëta me komunën për rregullimin e jetës komunitare
3.3	1.Mbikëqyrja dhe kontrolli	1. Ndërtimi i kapaciteteve për të mbikëqyrë dhe kontrolluar zbatimin e projekteve dhe shërbimet e ofruara	MAPL; Komunitat	1. Strukturat përkatëse të mbikëqyrjes dhe kontrollit raportojnë rregullisht në çdo tre muaj për mbarëvajtjen e punëve

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive

Nr	Fusha e Veprimit	Veprimi	Bartësi	Treguesi / rezultati
4.1	1.Kultivimi i ndjenjës së vullnetarizmit të qytetarëve	1.Hartimi i programeve informuese dhe trajnuese për kultivimin e ndjenjës së vullnetarizmit ;	Komuna; Shkollat; Qendrat Rinore; Komuniteti	1. Nxënësit dhe studentët marrin pjesë aktive në punë vullnetare në pastrimin e objekteve arsimore dhe mjedisit; 2. Grupet rinore dhe sportive marrin pjesë në zbatimin e projekteve të përbashkëta në komunitet;
4.2	2.Krijimi i qendrave për punë vullnetare	1. Hartimi i planeve për përfshirjen e qytetarëve në punë vullnetare në kuadër të lagjeve urbane dhe rurale	Komuna; Kabineti I Kryetarit; Qendra për përfshirjen e qytetareve dhe vullnetarizim; Komuniteti	1. Qytetarët kanë kuptuar rolin e tyre në procesin e planifikimit dhe marrin pjesë në qeverisjen lokale
	3.Fuqizimi i shoqërisë civile dhe i bizneseve të reja	1. Angazhimi i komunitetit të biznesit me përvojë në programe të mentorimit për ndërmarrësit e rinj.	Komuna: OJQ-të; Bizneset	1. Komunitet në partneritet me bizneset ndajnë bursa për studentë të fushave me nevojë për zhvillimin ekonomik të komunitetit. 2. Ndërmarrësit e rinj aftësohen rregullisht nga komuniteti i bizneseve për hapjen dhe menaxhimin e ndërmarrjeve të reja.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor

Nr	Fusha e Veprimit	Veprimi	Bartësi	Treguesi / rezultati
5.1	1.Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	1. Demonstrimi i planifikimit dhe i menaxhimi efektiv të burimeve lokale nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të komunitetit në proceset e planeve zhvillimore komunale dhe rajonale;	MAPL, Komunitet, MKRS, MTT, MAPH, OJQ, komunitetet	1 Është bërë inventarizimi dhe harta e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në secilën komunë;

		2. Forcimi i kapacitetit veprues të mekanizmave ndërqeverisës dhe të shoqërisë civile për komunikim efektiv ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal;		1. Janë zhvilluar projekte të përbashkëta për zhvillimin e turizmit kulturor dhe natyror të komunës;
5.2	1.Promovimi i diversitetit etnik dhe gjuhësor	1. Promovimi i i vlerave të diversitetit etnik dhe barazisë së përdorimit të gjuhëve;	MAPL; Komuna MKRS; OJQ; Komunitet	<p>1.Janë organizuar ekspozita arti, lojëra sportive dhe aksione vullnetare multietnike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore;</p> <p>2.Janë organizuar vizita të turistëve në vendbanimet ku përdoren gjuhë të ndryshme të komunitetit;</p> <p>3. Janë organizuar vizita të profesionistëve, shkencëtareve, universiteteve botërore, etj. për qëllime studimi etj. në institucionet publike dhe kulturore ku përdoret shumëgjuhësia;</p>